



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VI

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 3

Prishtinë, më 30.10.2017, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë : Daut Haradinaj, Besa Gaxherri, Liburn Aliu, Driton Çausi, Ganimete Musliu, Lutfi Zharku, Enver Hoti, Danush Ademi, Andin Hoti.

Munguan : Srdjan Mitroviq, Salih Salihu.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë : sipas listës së nënshkruar nga pjesëmarrësit.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Daut Haradinaj**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës ,
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 23.10.2017,
3. Takimi i komisionit me ministren e mjedisit lidhur me planin dhe prioritetet e ministrisë,
4. Shqyrtimi i draft planit të punës së komisionit për vitin 2017,
5. Të ndryshme

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës, njohërit uroi mirëseardhje anëtarit të ri **Driton Çausit** i cili zëvendëson Ali Lajcin nga VV.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 23.10.2017

Kryetari i Komisionit konstatoi miratimin e komisionit për procesverbalin nga mbledhja e kaluar.

3. Takimi i komisionit me ministren e mjedisit

Kryetari Daut Haradinaj falënderoj **ministren e mjedisit znj. Albena Reshitaj** për prezencën dhe njoftoi me rregullat e mbledhjes që ajo fillimisht të njoftoi komisionin për synimet e ministrisë pastaj anëtarët e komisionit të fokusohen në temat aktuale në mjedis me pyetjet eventuale që do të kanë, sidomos potencoi interesimin e qytetarëve rreth dërgimit të projektligjit për legalizimin e ndërtimeve pa leje ose shikimin e mundësisë së zgjedhjes së këtyre problemeve me ndërtimin me ndonjë marrëveshje në mes komunës dhe MMPH nëse vonohet ligji, për shkak të grumbullimit të problemeve, fjala është për ndërtimet e filluara por tani të pezulluara nga komunat deri në nxjerrjen e ligjit.

Ministrja e prezantoi ekipin dhe falënderoi gjithashtu për ftesën, ajo fillimisht u fokusua në objektivat e ministrisë së mjedisit për vitet 2017-2021 dhe sfidave që e presin këtë ministri duke numëruar veç e veç si dhe projektet që parashihen të zbatohen në bazë të buxhetit të paraparë, duke potencuar rëndësinë e inspektimeve që duhet të sigurohen dhe pa të cilin dikaster vështirë arrihen rezultatet.

Kryetari falënderoi për ekspozëun dhe filloi me dhenjen e fjalës anëtarëve të komisionit për parashkrimin e pyetjeve, **Besa Gaxherri** pyeti konkretisht për projektet që parashihen sidomos për mbeturina dhe lumenj si dhe për standardizimin e reklamimeve kurse **Liburn Aliu** u fokusua në problemet aktuale me ndërtimet të cilat janë bllokuar për shkak të aplikimeve, ndaj me të drejt shpresohet se këto çështje do të përmbyllen me ligjin e ri që pritët të vjen në kuvend, por me synim që të ndalohen ndërtimet pa leje sipas tij nga shkelësi kryesor i ligjit siç është qeveria e cila në vend se të jetë shembull pozitiv ajo aeroportin dhe autostradën e ndërton pa leje, ai kërkoi që planifikimi të paraprij hartave zonale dhe të sillet sa më shpejt ligji për tokën ndërtimore nga i cili ligj varet planifikimi kurse harta zonale e Kosovës duhet ti paraprij hartave zonale komunale, çështje tjetër me rëndësi është edhe fondi për mundësimin e shpronësimeve, oda e inzhinjerëve dhe licencimet, lumenjtë-ndër të parat duhet Drini i bardh të jetë prioritet për rehabilitim. **Ganimete Musliu** kërkoi angazhimin e MMPH në drejtim të lumenjve dhe mbeturinave sidomos për gurthyes të cilët degradojnë pamasë mjedisin me detonime të masave të ndryshme dhe plasaritje të shtëpive.

Driton Çausi shprehu mirëkuptim sa i përket lëshimeve të qeverive të kaluara por kërkoi fokusimin e MMPH në trajtimin e ndotjeve të ndryshme dhe të akustikës etj, trajtimin e moshës së makinave në Kosovë ngase kemi shfaqjen e sëmundjeve kancerogjene, planet për Kosovën e re etj. **Lutfi Zharku** pyeti për problemin e Shipitullës dhe dy apo tri sfida që parashihen nga kjo ministri që duhet zgjidhur. **Enver Hoti** gjithashtu u fokusua në degradimin e mjedisit sidomos duke pyet pse nuk miren masat e duhura nga inspekcioni dhe për çfarë arsye nuk funksionon ky dikaster i rëndësishëm mjedisor, ai potencoi se dhënja e një lejeje nuk zgjedh problemin por kriteret. **Andin Hoti** u angazhua për mbështetje pa rezervë MMPH-së që duhet ti jepet, si dhe potencoi lumin Drini i cili është shndërruar në rrezik potencial për jetën e qytetarëve, kërkoi rregullimin e shtratit të lumit Dri nga Ura e Fshajt deri ne Has, gjithashtu ti jepet rëndësi respektimit të ligjit përkatësisht eliminimit të rezistencave të krijuara gjatë viteve të kaluara etj.

Kryetari para se të jap fjalën ministres për pyetjet e parashtruara theksoi se parlamenti dhe deputetët janë ata që japin bazën ligjore duke hartuar legjislacionin kurse ministria është ajo që do ti zbatojë me përpikëri, kurse **Ministrja** u përgjigj pyetjeve me radhë fillimisht duke cekur projektet konkrete që parashihen, p.sh. për Drinin, Ibrin, Sitnicën, Morava e Binçës, Krena, Lumbardhi i Pejës etj, një marrëveshje me një qeveri të huaj shumilionësh etj kurse standardizimin e potencuar nga deputetja ajo e cilësoi se varet nga fakti se a kemi dëshirë dhe do ta bëjnë atë, sa i përket vjetërsisë së automjeteve po bashkëpunohet me ministrinë përkatëse sidomos edhe për makina hibride, ndotja nga termocentralet parashihet secila të ketë filtër, kontrolli i nivelit të ndotjes së ajrit, ndërprerja e kontratës 1.5 milionshe për mbikëqyrjen e zbatimit të projekteve, konsulencat e jashtme vetëm nëse ka nevojë, odat e inzhinjerëve githësesi të parashihen dhe të përgatitet për vitin 2018 ngase gjithsesi duhet të kemi këtë odë etj. Sekretari

i mjedisit **Arben Çitaku** u angazhua për disa përgjigje pasi kërkoi ministresha sidomos për gurthyes të cilat sipas tij nga MMPH marin pëlqimin pastaj procedohen tek tjerët por në fund pasojnë sanksionet me leje mjedisore dmth ata që nuk i plotësojnë kushtet penalizohen. Për SHIPITULLËN potencoi faktin se kryeministri dhe marrëveshja e tij me këta banor ka zhbllokuar këtë çështje duke prodhuar shumë aktivitete, ndaj janë formuar grupe punuese të cilat do të kontribuojnë në përfundimin e kësaj çështjeje pronësore dhe angazhimin e KEK-ut për marjen e masave për zhvendosjen e secilit banor veq e veq dhe dislokimin e tyre në lagjen HADE E RE por gjithnji sipas parimit të barabarësisë. **Lutfi Zharku** dysmoi për shkelje të ligjit në këtë çështje, por sekretari u përgjigj duke eliminuar këtë mundësi ngase secili rast apo pronë ka ekipin special sipas kornizës me të cilin lejohen këto veprime. Sa i përket legalizimeve sekretari premti se MMPH do ti përmbahet strategjisë e cila parasheh ti dërgohet kuvendit në fillim të dhjetorit kurse sa i përket a ka leje aeroporti dhe autostrada ai dha sqarime për Liburn Aliun se lejet ekzistojnë i cili pastaj nuk kundërshtoi përgjigjen e dhënë nga sekretari i MMPH. Gjithashtu sekretari sipas pyetjes së **Besa Gaxherrit** u përgjigj se cili gurthyes konkretisht është mbyllur deri tani. Për pyetjen e **Driton Çaushit** rreth moshës së automjeteve tha se ligji kufizon deri 8 vjet, mirëpo potencoi se MMPH miret me lirimin e gazrave. **Danush Ademi** pyeti për projektet e puseve në Gadime pse janë reduktua, mirëpo sekretari tha se janë përcjellur për vitin 2018.

Duke falënderuar ekipin e ministres nga MMPH, **Kryetari z. Haradinaj** edhe një herë bëri apel që MMPH ta dërgoi projektin për legalizimin e ndërtimeve pa leje ngase sipas interesimit që shfaqet në këtë komision, shihet se kjo çështje është gjithnjë duke u dramatizuar.

4.Të ndryshme

Në pikën të ndryshme Kryetari njoftoi për mbledhjen e radhës me 6 nëntor kur komisioni do ti përmbledhë çështjet që u diskutuan në dy mbledhjet me ministrat përkatës dhe eventualisht inkorporimin e propozimeve në planin e punës për vitin 2017.

Mbledhja përfundoi në orën 12,45.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Daut Haradinaj